



Raportit të Punës për vitin 2019 Janar-Dhjetor

**Në vazhdim do ti veçojmë aktivitetet e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut të cilat janë realizuar gjatë periudhës një vjeçare, Janar-Dhjetor 2019**

1. Bashkëpunim dhe koordinimi i aktiviteteve të zyrtareve të NJKDNJ-së me Drejtorin e Administratës së Përgjithshme.
2. Bashkëpunimi i Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut me Institucionet Lokale dhe ato Qendrore, OJQ-të, etj.
3. **Raportimi (PVMSA) koordinimi i NJKDNJ-së, me Zyrtarin për Integritet Evropian.** Bashkëpunim i ndërsjell i NJKDNJ-së me Zyrtarin e Integritet Evropian ku gjatë vitit në afate të caktuara kohore raportojmë në fushën e të Drejtave të Njeriut sa i përket aktiviteteve dhe punës së NJKDNJ-së gjatë periudhave të caktuara kohore.
4. Kërkesë zyrtëre Ligjore për Hartimin e Rregullores për të drejtat e fëmijëve dhe formimit të Komitetit Konsultativ për personat me nevojat të veçantë, ku është hartuar Rregullorja për të drejtat e fëmijëve dhe ka kaluar në Kuvend,
5. Është formuar Këshilli konsultativ për personat me nevojat e veçanta me kërkesën e NJKDNJ.
6. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve, si Koordinator e NJKDNJ-së, kam vizituar Qendrën për Punë Sociale në Rahovec, gjatë vizitës jam informuar rreth gjendjes reale në komunën tonë lidhur me fëmijët të cilët janë të përfshirë në punë të rënda. Sipas drejtorit të QPS-së, në Komunën e Rahovecit gjatë këtij viti nuk ka pasur rast të evidentuar, të fëmijëve të cilët punojnë, punë të rënda, e që kjo është për tu vlerësuar.
7. **Ditës Ndërkombëtare kundër kancerit**, gjatë kësaj kemi mbajtur takime /tryeza vetëdisuese për sensibilizimin e qytetarëve për të bërë kontrolla mjekësore të rregullta ngase “Zbulimi i hareshëm-shpëton jetë”, këto aktivitete janë bërë në bashkëpunim me Grupin e grave, OJQ „Hareja” dhe Qendra Rinore SHL Kosova në Rahovec.
8. **Bashkëpunim i NJKDNJ-së dhe Policisë së Kosovës**, janë organizuar takime të shpeshta dhe bashkëbisedimi për rastet të ndryshme për të mitur dhe dhunës në familje.
9. **Bashkëpunim i ndërsjell i NJKDNJ-së me Avokatin e Popullit**, Avokati i Popullit Regjional në bashkëpunim me Koordinatorin e NJKDNJ-së kanë organizuar ditë të hapura (një herë në muaj takim me qytetar), qytetarët kanë pasur rastin të paraqesin ankesat e tyre. Ankesat më të shpeshta të qytetarëve ishin konflikte pronësore gjithashtu edhe ankesat të prolongimit të lëndëve nëpër gjykata.  
Në bashkëpunim me zyrtari i Avokati të Popullit janë mbajtur dy ligjërata me nxënë të shkollave „Bekim Sylka”, dhe „Gëzim Hamza” në Rahovec me temën „Të Drejta e Fëmijëve dhe ndëshkimet trupore me mësimdhënës”

10. Takim me përfaqësuesit dhe anëtarët e HandiKosit lidhur me Rolin dhe Funkcionimin e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut. Në takim është diskutuar për aktivitetin "Dyert e hapura me qytetarë" organizim i NJKDNJ-së në bashkëpunim me Avokatin e Popullit.
11. **FUSHATA KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE** - Ditës Evropiane Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe fillimit të fushatës Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore ,Habibe Haxhimustafa, Koordinatore e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Rahovecit në bashkëpunim me OJQ „Qeliza” ka organizuar ligjërata nëpër shkolla të mesme të komunës sonë me temën: “Rritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të nxënësve në lidhje me rrezikun dhe pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore”.
- Përmes kësaj fushate kemi arritur që të ndihmojmë dy nga vajzat e trafikuar me nga një makinë për qepje me qëllim që vajzat të largohen nga punët e këqija trafikuese dhe të kenë me çka të merren, vajzat ishin , një nga Rahoveci dhe një nga Opterusha.
12. Me psikologët e Organizatës „Medika Kosova”, janë trajtuar disa raste të grave dhe vajzave nga Komuna e Rahovecit të dhunuara gjatë luftës të cilët janë paraqitur në zyrën për të drejtat e njeriut ku janë duke u përgatitur për aplikim para komisionit qendror.
13. **Takimet e Rregullta me Grupin Lokal të Veprimit**
14. **Pjesmarje në Konferenca:**
1. Sfida dhe të ariturat e gruas Shqipëtare
  2. Dita e hapur globale e Kombeve të Bashkuara
  3. Bashkëpunimi Ndërinstitucional në raport me zbatimin e rekomandimeve të IAP
  4. Qasja e gruas në pronë
15. Si Kryetare e Komisionit Komunal për Ri-atdhesim (KKR) janë mbajtur gjithsej katër takime për shqyrtimin e Kërkesave të Ri-atdhesuarve të Komunës së Rahovecit.
- Lëshuara e Vërtetimeve si dhe regjistrimi i personave të Ri-atdhesuar në sistemin elektronik të të dhënave të punuar dhe licencuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamentit për Ri-atdhesim. Vërtetimet janë të dedikuara Entit të Punësimit në Rahovec, Kryqit të Kuq, Nëna Terez, organizatave ndërkombëtare IOM-URA-AËO Nureberg, GIZ, IADK, Diakonie Kosova si dhe të gjitha organizata të tjera ndërkombëtare dhe ato vendore të cilët veprojnë në Kosovë.
- Vlen të ceket se të gjithë persona dhe familje të lajmëruara në zyrën tone ku i kryejm shërbimet e Ri-atdhesimit në Rahovec janë pritur dhe janë informuar në detaje lidhur me procesin e Ri-atdhesimit dhe mënyrën e përfitimit.
- Bazuar në rregulloren komunale 13/2017 e cila ka hyrë në fuqi, në muajin shtator të vitit 2017, njëra ndër pikat thotë se të larguarit e viteve të fundit 2014-2015 nga shteti kanë të drejtë të aplikojnë në përfitimin e plan biznesit.
- Komisioni komunal ka kompetencë të caktoj dhe përzgjedh përfituesit për akomodim, rindërtim apo ndërtim të shtëpive dhe dru zjarri. Ky është ndryshimi i cili ka rrjedhur nga rregullorja aktuale për dallim nga ajo e kaluara. Tani jemi në pritje që kjo Rregullore të ndryshoj prapë.
- Mund të themi se në tregun e punës janë regjistruar të gjitha vërtetime të lartcekura dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë kyçur, në këtë sistem të punës. Ky program ka filluar që në vitin 2016 dhe se ka vazhduar edhe në vitin 2017 ,2018 dhe 2019 me të njëjtat kritere.
- Si kryetare e komisionit për gjatë gjithë kohës së raportimit, ka pasur takime të mirëfillta me Ministrinë e Punëve të Brendshme-Departamentin e Ri-atdhesimit , zyrën regjionale si dhe të gjitha kërkesat dhe pyetjet të cilat kanë rrjedhur nga të përmendurit janë plotësuar dhe dorëzuar me kohë. Takime të kohës me Entin e Punësimit, Kryqin e Kuq në Rahovec dhe

takimet në vazhdimësi me organizatat të ndryshme që tregojnë interesim për të ndihmuar personat e Ri-atdhesuar.

**PËRFITUES TË PLAN BIZNESIT VLERA 3.000<sup>00</sup> € nga UNDP-:**

1. Dardan Krasniqi-Senovc
2. Gëzim Cena-Rahovec
3. Fejz Gashi-Bratatin
4. Bedri Krasniqi-Senovc
5. Hysen Shala-Zaqisht
6. Nevruz Seferi-Petkoviç

Këta njëherit janë edhe përfituesit e Planit të Biznesit në vlerë 3.000 €

Përfituesit e Planit të Biznesit janë të obliguar që ta regjistrojnë Biznesin e tyre menjëherë.

Këta persona tani më llogariten si të punësuar pasi që pranë zyrës së punësimit ishin të regjistruar si të pa punë.

**JANË NDËRTUAR SHTËPI KËTYRE TË RI-ATDHESUARVE:**

1. Zhaerzino Rrustemi – Të gjitha punimet kanë përfunduar por pritet që të mobilohet shtëpia për këtë edhe personi në fjalë ende nuk mund të banojë aty dhe se ende i paguhet qiraja për akomodim.

2. Reshat Hamza (9 anëtarë) shtëpia prej 75 m<sup>2</sup>, kanë përfunduar të gjitha punimet dhe pritet të mobilohet. Kjo familje është vendosur në këtë shtëpi të jetojë edhe pse ende nuk është mobiluar. Këtë familje e kemi vizituar bashkë me ambasadorin gjerman duke kërkuar që sa më shpejtë të ndihmohet edhe me mobile dhe sende të tjera.

1. Latif Zena-I është ndërtuar shtëpia në sipërfaqe 45 m<sup>2</sup>, pritet së shpejti të mobilohet shtëpia

**Të akomoduar gjatë vitit 2019:**

1. Zhaerzino Rrustemi-E paguar nga MPB-ja projekti për riatdhesim
2. Latif Zena - paguar nga MPB-ja
3. Magbule Popaj -e paguar nga buxheti I Komunës/Rahovec.

**Habibe Haxhimustafa**

**Koordinatorë e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut**